



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 18 dhe 20 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2024, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Bekim Shabani, Drejtor i Drejtoratit për Prokurim nga ekzekutivi i Komunës,
2. Latif Ramadani, Drejtor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa nga ekzekutivi i Komunës
3. _____nga subjektet politike
4. _____nga subjektet politike
5. Leotrim Pajaziti ,nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2

Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 3
Detyrat e Komisionit

Komisioni i ankesave shqyrton ankesat e palëve të pakënaqura nga procesi i vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues, konform procedurave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës .

Komisioni bën shqyrtimin e ankesave brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike

Neni 4
Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj , Rregulloren e cekur dhe me këtë vendim do ti ndihmojë Zyra Kryetarit të Komunës - Sektori pronësor - juridik.

Neni 5
Kompensimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre do të kompenzohen në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse . Kompensimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompensimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 18 dhe 20 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021.Komisioni i ankesave ka qenë i themeluar paraprakisht me Vendim të Kuvendit të Komunës mirëpo i ka përfunduar mandati i përcaktuar me dispozitat e Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ku është përcaktuar që mandati i anëtarëve të Komisionit të ankesave është 2 (dy) vite brenda mandatit të Kuvendit të Komunës dhe ka qenë e domosdoshme të miret Vendim për themelimin e Komisionit të ri të ankesave me mandat gjithashtu dy (dy vjeçar) brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Nga të cekurat më lartë, propozojmë miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/04-14781

Lipjan, Më 14.03 2024

